

FAKTE MBI VENDIN

KOSOVË

(October 2016)

Mohim

IOM ka mbledhur të dhënat me kujdes të veçantë. IOM ofron informata me njohurinë më të mirë dhe me vetëdije të plotë. Pamarrë parasysh, IOM nuk mund të mbahet përgjegjës për saktësinë e informatës së dhënë. Për më tepër, IOM nuk do të merret si përgjegjës për çfarëdo përfundimi arritur nga informatat e ofruara nga IOM.

Përmbajtja

I. LISTA	1
1. Për të bërë para kthimit:	1
2. Për të bërë menjëherë pas kthimit:	1
II. KUJDESI SHËNDETËSOR	2
1. Sistemi i kujdesit shëndetësor	2
2. Trajtimi mjekësor dhe disponueshmëria dhe çmimet e barërave	2
III. TREGU I PUNËS DHE PUNËSIMI	3
1. Gjendja në tregun e punës	3
2. Mënyra / ndihma për punësim	3
3. Ndihma për të papunët	3
4. Mundësitë për arsim të mëtejshëm dhe trainimet profesionale	3
IV. STREHIMI	3
1. Gjendja e strehimit	3
2. Mënyra/ndihma në gjetjen e banimit	3
3. Grantet sociale për strehim	4
V. MIRËQENIA SOCIALE	4
1. Sistemi i mirëqenies sociale	4
2. Sistem pensional	4
3. Grupet e cenueshme	4
VI. ARSIMI	5
1. Sistemi arsimor	5
2. Qasja dhe procedura e regjistrimit, veçanërisht për të kthyerit	5
3. Shpenzimit, kreditë dhe bursat	5
4. Miratimi dhe vërtetimi i diplomave të huaja	5
VII. PËRKRAHJA KONKRETE PËR TË KTHYERIT	5
1. Programet e ndihmës në riintegrim	5
2. Përkrahja për fillimin e aktiviteteve të gjenrimit të të ardhurave	5
VIII. INFORMATAT E KONTAKTEVE DHE VEGËZA TË DOBISHME	6

I. LISTA

1. Për të bërë para kthimit:

I kthyeri duhet:

- Të kërkojë dokumentat nga autoritetet gjermane, të cilat mund t'i nevojiten më vonë.
 - Duhet patjetër: Çertifikatat e lindjes për fëmijët e lindur në Gjermani (pa ato mund të paraqiten probleme serioze gjatë hyrjes në shtet ose gjatë procedurës së regjistrimit); diplomat e shkollës dhe çertifikatat e kurseve apo trainimeve të ndjekura.
 - Rekomandohet: Letër rekomandimi nga punëdhënësit, patenta e shoferit e BE, vërtetimi i përfshirjes në çfarëdo biznesi, shoqatë kulturore apo sportive është i rëndësishëm së lartë.
- Të ketë informata lidhur me arritjen në aeroport dhe udhëtimin e mëtejshëm.
 - Në 6-7 vjetët e fundit infrastruktura rrugore, përmes investimeve qeveritare, është përmirësuar dukshëm. Në vitet e fundit është ndërtuar autoudha e parë, e cila e lidhë Kosovën me Shqipërinë.
 - Infrastruktura hekurudhore është në gjendje të dobët dhe përdoret në masë të kufizuar. Ekzistojnë dy rrugë kryesore të mbuluara me transport hekurudhor për udhëtarë: Prishtinë-Pejë-Prizren dhe Prishtinë-Kaçanik. Shumë segmente hekurudhore janë jashtë përdorimit.
 - Transporti me taksì është i disponueshëm dhe është shërbim shumë i përhapur në vend, por nuk është formë shumë e popullarizuar transporti për shkak të çmimit të lartë të shërbimeve të ofruara nga kompanitë e taksive.
 - Nuk ka asnjë pjesë të paarrishme të vendit përveç disa rasteve në sezonën e dimrit, të cilat karakterizohen me reshje të shumta të borës.
- Kontrollon vaksinimin (veçanërisht për fëmijët).
Programi i vaksinimit në Kosovë:
 - Pas lindjes: vaksinat kundër BCG dhe Hepatitit B duhet të injektohen të parat, përderisa vaksinat e DTP, Poliomiellitit, Hepatitit B dhe Hib 1 duhet të injektohen gjatë muajit të dytë të jetës së fëmijës.
 - Në muajin e tretë të jetës, fëmija merr vaksinat kundër DTP, Poliomiellitit dhe Hib 2 për të vazhduar me vaksinat kundër DTP, poliomiellitit, Hepatitit B dhe Hib 3 në muajin e katërt të jetës. Cikli kompletetohet me vaksinimin MMR, i cili bëhet në mes të muajit të 12-të dhe 18-të të jetës.
 - Fazat e ardhshme: Në moshën 6-7 vjeçare, fëmijët marrin vaksinën kundër DT, Poliomiellitit dhe MMR përmes gojës. Procesi përfundon në mes të moshës 12-18 vjeçare, kur fëmijët/tinejxherët marrin vaksinat kundër Poliomiellitit, DTP dhe TT (Tetanusit). Nëse ky cikël nuk është kompletuar, vaksinimi duhet të vazhdohet aty ku është ndërprerë paraprakisht.
- Gjejë strehim të përkohshëm.
Menjëherë pas kthimit, të kthyerit shpeshherë nuk kanë ku të shkojnë. Është i mundur strehimi deri në shtatë ditë në qendrat e pranimit të qeverisë, të udhëhequra dhe të mbuluara nga qeveria.

2. Për të bërë menjëherë pas kthimit:

I kthyeri duhet të:

- Regjistrohet tek autoritetet përkatëse
 - Regjistrimi i parë: Me rastin e kthimit, regjistrim ky i udhëhequr nga departamenti i Riintegritimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme, menjëherë pas kalimit të kontrollës kufitare në aeroport apo pikëkalimet kufitare tokësore.
 - Regjistrimi në Zyren Administratës së Çështjeve Civile, në mënyrë që të aplikojë për letërnjoftimi dhe të regjistrohet në librat civilë të Kosovës (nëse nuk është bërë më heret). Për këtë qëllim, aplikuesi duhet të vërtetojë identitetin, duke ofruar ndonjë nga dokumentat e vjetra kosovare (letërnjoftimi, certifikata e lindjes apo pasporti). Fëmijët e lindur në Gjermani, duhet të paraqesin çertifikatën e përkthyer të lindjes, të lëshuar nga autoritetet gjermane, apo Formën A (certifikatë ndërkombëtare e lindjes), e cila është vërtetuar dhe vlerësuar nga autoritetet qendrore në proces special. Për këto raste, aplikuesit duhet të aplikojnë në zyren komunale e Gjendjes Civile. Prindërit poashtu duhet të paraqesin çertifikatën e martesës dhe pasaportat.
 - Pas marrjes së letërnjoftimit, duhet të vizitohet qendra e punësimit.
- Aplikojë për mirëqenie sociale.
Zyrat e ndihmës sociale, janë të themeluara në të gjitha qytetet e vendit. Kriteret për përfitim nga ndihma sociale janë strikte dhe vetëm personat në nevojë ekstreme do të mund të përkrahen.

- Kontaktojnë shërbimet që ndihmojnë në hulumtimin për punë dhe strehim. Zyrat e punësimit gjenden në të gjitha qytetet e Kosovës dhe të kthyerit duhet t'i vizitojnë ato me qëllim të regjistrohen si punëkërkues. Të kthyerit duhet të sjellin me vete letërnjoftimin e lëshuar nga autoritetet kosovare.
- Aplikojë për kujdes ndaj fëmijës, shkollë apo institucione të tjera arsimore.
 - Objektet e qëndrimit ditor janë shumë të përhapura në Kosovë, veçanërisht nëpër qytete, si në pronësi private ashtu edhe publike.
 - Regjistrimi në shkollë është proces i lehtë. Aftësitë e fëmijëve të kthyer do të vlerësohen nga Bordi përkatës i shkollës në mënyrë që të përcaktohet se në cilën klasë duhet të regjistrohet fëmija përkatës. Diplomat dhe certifikatat e fituara në vendin e qëndrimit, poashtu duhet të paraqiten.

II. KUJDESI SHËNDETËSOR

1. Sistemi i kujdesit shëndetësor

a. Informata të përgjithshme për sistemin e kujdesit shëndetësor

Sistemi i kujdesit shëndetësor në Kosovë është i organizuar në tre nivele: parësor, dytësor dhe tretësor. Kujdesi parësor shëndetësor (KPSH) ofrohet në qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare, të cilat operojnë në mbi 30 komuna nëpër tërë Kosovën me mundësi shumë të kufizuara diagnostike. Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe ambulancat e shërbimeve shëndetësore, ofrojnë shërbimet e kujdesit parësor themelor.

Shërbimet dytësore të kujdesit shëndetësor ofrohen në gjashtë spitale regjionale, të lokalizuara në qytetet kryesore të Kosovës. Të gjithë spitalet janë operacionalë por mundësitë laboratorike dhe departamentet për rentgen janë të kufizuara. Secili nga spitalet regjionale kanë nga 450-550 shtretër.

Kujdesi tretësor shëndetësor ofrohet në Qendrën Klinike Univerzitare, që gjendet në Prishtinë dhe ka në dispozicion 2,500 shtretër.

b. Qasja, veçanërisht për të kthyerit:

- Shërbimet e kujdesit shëndetësor ofrohen pa pagesë nga institucionet shëndetësore publike, për grupe specifike njerëzish dhe të kthyerit kanë qasje të mirë në të gjitha rastet.
- Në Kosovë ende nuk ka sigurim shëndetësor. Kompanitë private ofrojnë sigurime shëndetësore, por ato janë shumë të shtrenjta.

2. Trajtimi mjekësor dhe disponueshmëria dhe çmimet e barërave

a. Objektet mjekësore dhe mjekët

- QKU (Qendra Klinike Univerzitare) është institucioni kryesor publik shëndetësor dhe gjendet në Prishtinë. QKU është ombrellë e 15 klinikave që operojnë nën mbikëqyrjen e saj. Klinikat në vijim operojnë në kuadër të QKU: Njësia e anesteziologjisë dhe e kujdesit intenziv, klinika e sëmundjeve të lëkurës dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, Qendra e kujdesit emergjent, Klinika e gjinekologjisë dhe obstetrikës, e neurologjisë, e neurokirurgjisë, e ortopedisë, e pediatriisë, e kirurgjisë pediatrike, e psikiatriisë, e mushkërive, e kirurgjisë, e urologjisë, barnatorja kryesore, instituti kombëtar i shëndetit publik.
- Sektori i konsoliduar shëndetësor privat, mbulon shumë fusha shëndetësore: shërbimet janë të kualitetit më të lartë se në QKU, por çmimet nuk janë të përbalueshme për popullësinë e gjërë. Klinikat më të mirënjohura në vend janë: Spitali Amerikan, Klinika Aloka si dhe spitalet Bahceci, Euromed dhe Rezonanca.

b. Procedurat e pranimit

Personat, së pari, duhet të kontaktojnë institucionet e nivelit parësor të sistemit shëndetësor, Qendrën e Mjekësisë Familjare apo Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare. Nëse ka nevojë për përcjellje të mëtejme të gjendjes, atëherë duhet të vizitohen spitalet regjionale të themeluara në regjionet kryesore të Kosovës. Nëse shërbimet e nevojshme nuk janë të disponueshme në nivelin dytësor të sistemit shëndetësor, atëherë pacientët marrin udhëzimin për trajtim në nivelin e tretë, në QKU në Prishtinë.

c. Disponueshmëria dhe çmimet e barërave

Barërat esenciale do të duhej të jenë të disponueshme, pa pagesë, në të gjitha qendrat e shërbimit publik shëndetësor, por shpeshherë ato mungojnë dhe nuk janë në dispozicion në klinikat publike. Barnatoret private kanë mundësi t'i importojnë barërat e nevojshme, por ato zakonisht janë të shtrenjta, ndërsa furnizimi mund të jetë i pasigurt. Ekziston mundësia e importimit të barërave nga regjionet/shtetet fqinje dhe më gjerë.

III. TREGU I PUNËS DHE PUNËSIMI

1. Gjendja në tregun e punës

a. Fuqia punëtore

- Zyrtarisht, numri i personave të punësuar në Kosovë është 323,508 në të dy sektoret, publik dhe privat. Sidoqoftë, numri nuk është indikator i saktë, për shkak të numrit të madh të punës në tregun joformal. Mosha ligjore e punësimit në Kosovë është 18, ndërsa mosha e pensionimit është 65.
- Bazuar në Raportin vjetor për vitin 2014, botuar në 2015 nga MPMS, më së shpeshti ofrohet punësimi në sektorin e shërbimeve dhe ndërtimtari, ndjekur nga prodhimtaria dhe bujqësia.

b. Të ardhurat mesatare: 200 EUR

c. Të dhëna të rëndësishme për situatën ekonomike

- GDP për kokë banori: 3,050.00 EUR (Burimi: Ministria e Zhvillimit Ekonomik; QeK)
- Rritja ekonomike: 3.8% në 2015 (Burimi: Ministria e Zhvillimit Ekonomik; QeK)
- Niveli i varfërisë: 29.7% (Burimi: UNDP)

d. Shkalla e papunësisë

- Bazuar në departamentin e punësimit të MPMS shkalla zyrtare e papunësisë është 35.3%, përdërisa shkalla e papunësisë së të rinjve (grupmosha 18-24) është 61%.
- Numri i përgjithshëm i personave të papunë të regjistruar si punëkërkuar tek entet publike të shërbimeve të punësimit: (fundi i 2014): 127,921 femra dhe 146,566 mashkuj.
- Numri i përgjithshëm i punëkërkuarve "të pakualifikuar": 156,881 persona (fundi i 2014).

2. Mënyra / ndihma për punësim

- Vendet e punës për sektorin publik publikohen në web faqe dhe në gazetatat kombëtare, por edhe fizikisht në tabelat informative të institucioneve apo agjensioneve, të cilat shpallin vendet e lira të punës. Në sektorin privat më e përhapur është mënyra jo-formale (përmes fjalës).
- Punësimi në sektorin privat është i pazhvilluar. Disa nga web faqet kryesore janë: appk.org | www.ofertapune.com | www.portalpune.com | www.shkabaj.net | www.portalpune.com | gjirafa.com

3. Ndihma për të papunët

Në Kosovë nuk ofrohet ndonjë skemë për përkrahje për të papunët.

4. Mundësitë për arsim të mëtejshëm dhe trainimet profesionale

- Trainimet në QAP u ofrohen: personave të papunë dhe punëkërkuarve të regjistruar, përfshi grupet etnike minoritare dhe grupet e cenuara.
- Trainimet e disponueshme profesionale: kontabilitet, saldim, parukeri, elektrikist, kompjuterë, hidraulikë, ndërtimtari, zdrukthtari, rrobaqepësi etj.
- Vendndodhja e QTP: Prishtinë, Mitrovicë, Dolane, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Dy Qendra të Kompetencës gjenden në Skenderaj dhe Malishevë, për Ndërtimtari te ulët dhe të lartë, Tregti, Administratë dhe Tregti.

IV. STREHIMI

1. Gjendja e strehimit

a. Qiraja mesatare, shpenzimet/komunalitë (p.sh. rryma, uji, etj.)

- Qiratë mesatare mujore në Prishtinë janë: Studio/banesë: 150-200 EUR; banesë me një dhomë fjetje: 200-250 EUR; banesë me dy dhoma fjetje: 250-350 EUR; banesë me tri dhoma fjetje: 300-500 EUR. Qiratë në qytetet tjera të Kosovës (p.sh. Pejë, Mitrovicë, Ferizaj) janë afërsisht 50-80 EUR më lirë se në Prishtinë.
- çmimi për KW rrymë elektrike është 0.055 EUR, ndërkaq çmimi për 1 m³ ujë për amvisëri është 0.350 EUR.

b. Kërkesa dhe oferta

Ndërtimtaria është një nga sektoret me zhvillimin më të shpejtë në vend, por kërkesa për banesa është ende e lartë, kryesisht për shkak të lëvizjeve migratore të popullatës rurale në qytete. Kjo kërkesë i mban çmimet e qirave ende në nivel mjaft të lartë.

c. Strehimoret për të kthyerit/strehimi social

Nuk ekzistojnë objekte specifike për strehimin e të kthyerve, përveç qendrës së pranimit të refugjatëve, ku strehohen azilkërkuarët në Kosovë. Të kthyerit kryesisht vendosen në banesa të marra me qira, për një kohë maksimale prej një viti.

2. Mënyra/ndihma në gjetjen e banimit

Apartamentet mund të gjenden përmes agjencive imobiliare nëpër tërë vendin apo përmes hulumtimit

vetanak. Brenda qytetit në Prishtinë, çmimi i blerjes së 1 m² të apartamentit apo shtëpisë është mes 700 e 800 EUR, derisa çmimet në qytetet tjera janë më të ulëta, mes 500 e 600 EUR.

Web faqet kryesore: www.kosova-immobilien.com | <http://kosova-estate.com> | www.prona.net

3. Grantet sociale për strehim

Qendrat për punë sociale janë ofruesit kryesorë të granteve për strehim social, përveç përkrahjes së herë-pas-hershme që ofrojnë disa OJQ. Megjithatë, këto qendra ndihmojnë vetëm ata persona, të cilët janë shfrytëzues të ndihmave nga skemat sociale dhe në raste të veçanta, ata të cilët kanë qenë të prekur nga fatkeqësitë natyrore si: zjarri, termetet, vërrshimet, etj.

V. MIRËQENIA SOCIALE

1. Sistemi i mirëqenies sociale

a. Informata të përgjithshme për sistemin e mirëqenies

Për të marrë ndihmë sociale, aplikantët duhet të paraqiten në Qendrat për punë sociale dhe të informohen nëse i përmbushin kriteret të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

b. Qasja, veçanërisht për të kthyerit

- E drejta dhe kushtet
 - Kategoria e parë: personat mbi moshën 18 vjeçare, me paaftësi të përhershme dhe të paaftë për punë; personat mbi moshën 65 vjeçare; kujdestarët e përhershëm për personat me paaftësi dhe mbi moshën 65 vjeçare; personat deri në moshën 14 vjeçare; personat mes moshës 15 dhe 18 vjeçare, në shkollim të rregullt; dhe prindërit e vetëm, me së paku një fëmijë nën moshën 15 vjeçare;
 - Kategoria e dytë: Familjet me një person të aftë për punë dhe së paku një fëmijë nën moshën pesë (5) vjeçare, apo në përkujdesje të përhershme të një fëmije jetim nën moshën 15 vjeçare.
 - Të njëjtat kushte vlejné edhe për të kthyerit.
- Procedura e regjistrimit për sigurim social/sigurim
 - Qendrat gjenden në çfo komunë të Kosovës. Aplikantët duhet të paraqesin dokumentin e papunësisë i cili lëshohet nga zyrat e punësimit në komunën përkatëse.
- Dokumentat e nevojshme
 - Letërnjoftimi i Republikës së Kosovës, çertifikatat e lindjes së të gjithë anëtarëve të familjes, çertifikata e vdekjes/shkurorëzimit dhe deklarata e bashkësisë familjare.

c. Përfitimet

Personi duhet të paraqitet në qendrën më të afërt të mirëqenies sociale për informata të mëtejme dhe paraqitjen e dokumentave. Shuma më e lartë e ndihmës për prindërit e vetëm është 90 EUR në muaj dhe është e vetmja ndihmë. Skema sociale është jo-fleksibile, kështuqë asnjë formë tjetër e ndihmës (p.sh. ndihmë për fëmijë) nuk është e disponueshme.

2. Sistem pensional

a. Informata të përgjithshme për sistemin pensional

- Fondi publik i sigurimit pensional: 10% e të ardhurave bruto të punëtorëve duhet të paguhet në këtë fond, 5% nga punëdhënësi dhe 5% nga punëtori.
- Pensioni bazë (apo i pleqërisë) është një nga format e detyrueshme të pensionit dhe i ipet secilit shtetas të përhershëm të Kosovës mbi moshën 65 vjeçare, pa kurrfarë kushtesh të tjera. Skema mujore e pensionit bazë është 75 EUR. Baza e skemës së pensioneve për pensionistët kontributdhënës është 158 EUR. Shpenzimet mjekësore duhet të mbulohen personalisht.

b. Qasja, veçanërisht për të kthyerit

- E drejta dhe kushtet
 - Secili shtetas i Kosovës ka të drejtë t'i qaset fondit bazë pensional të Kosovës, përderisa skemës së pensionit kontributdhënës mund t'i qasen vetëm personat që kanë punuar dhe kanë kontribuar në fondin pensional.
- Dokumentat e nevojshme:
 - Skema e pensionit bazë: letërnjoftimi i Republikës së Kosovës
 - Skema e pensionit kontributdhënës: letërnjoftimi, çertifikata ose diploma e nivelit arsimor dhe çertifikata e lindjes.

3. Grupet e cenueshme

a. Informata të përgjithshme për grupet e cenueshme

Kategoritë e njohura sipas ligjit në fuqi: nënat vetushqyese, fëmijët e mitur dhe të pashoqëruar, viktimat e trafikimit, personat e paaftë (me autizëm). Qasja në shërbime sociale është shumë e kufizuar dhe vlerësimi është shumë strikt, përmes kritereve mjaft të vështira të fitimit të së drejtës, si rezultat i burimeve të kufizuara financiare të qeverisë.

b. Ndihma për personat e cenueshëm

Qendrat për punë sociale janë kontribuesit kryesorë për mirëqenien e grupeve të cenueshme. Disa OJQ dhe organizata ndërkombëtare bëjnë përkrahjen e grupeve të cenueshme të caktuara, si për shembull viktimat e trafikimit dhe fëmijët e mitur dhe të pashoqëruar.

VI. ARSIMI

1. Sistemi arsimor

Informata të përgjithshme për sistemin

- Arsimi i detyrueshëm: mosha 6 deri 11 vjeçare (klasat 6-11)
- Pas përfundimit të shkollës së mesme, nxënësit duhet të hyjnë në testin kombëtar.
- Studimet janë të disponueshme në nivelin Bachelor, Master dhe PhD. Studentët mund të zgjedhin studimet me kohë të plotë apo të shkurtuar. Univerziteti i Prishtinës (UP) është i vetmi univerzitet publik në Kosovë.

2. Qasja dhe procedura e regjistrimit, veçanërisht për të kthyerit

- Procedurat e regjistrimit në shkollë janë mjaft të thjeshta, të hapura dhe gjithpërfshirëse. Prindërit duhet të këshillohen me përfaqësuesit e shkollës më të afërt me vendbanimin e tyre në mënyrë që të regjistrojnë fëmijët e tyre. Ata duhet të paraqesin çertifikatën e lindjes për fëmijët që regjistrohen në shkollë për herë të parë.
- Fëmijët që kthehen që marrin pjesë në programe riintegruese nga paketa qeveritare për reintegrim, përkrahen në shkollim.

3. Shpenzimit, kreditë dhe bursat

a. Informata të përgjithshme për tarifën e shkollimit

Shkollat publike fillore dhe të mesme nuk aplikojnë tarifa të shkollimit, por ato aplikohen për nivelin e lartë dhe institucionet arsimore private të të gjitha niveleve.

b. Qasja dhe kushtet për bursa dhe/ose kredi për mbulimin e tarifave

Qeveria nuk ofron bursa për studim, por nuk ka as kredi për studim. Ndonjëherë, organizatat ndërkombëtare dhe lokale, ambasadat, fondet e bamirësisë e herë-pas-herë edhe institucionet qeveritare ofrojnë ndihmë për studentët.

4. Miratimi dhe vërtetimi i diplomave të huaja

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është i autorizuar për njohjen e diplomave të huaja. Përgjegjësia e tij është mbikqyrja e kualifikimeve kombëtare, së bashku me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Agjensionin e Akreditimit dhe trupat e tjerë profesionalë të njohur nga qeveria për këtë qëllim dhe në veçanti njohja e kualifikimeve profesionale dhe diplomave të huaja.

VII. PËRKRAHJA KONKRETE PËR TË KTHYERIT

1. Programet e ndihmës në riintegrim

- Qeveria e Kosovës ka buxhetuar fondin riintegrues prej 3.5 milion EUR për të ndihmuar të kthyerit e Kosovës. Përkrahja përfshin gjëra ushqimore dhe jo-ushqimore, strehim, fillimin e biznesit dhe rinovim dhe rindërtim të shtëpisë. Të kthyerit mund t'i qasen shumicës së skemave të riintegrit, si: punësimi, fillimi i biznesit, gjëra ushqimore dhe jo-ushqimore, pako higjienike, por nuk mund të përfitojnë nga skemat e rinovimit dhe rindërtimit të shtëpisë (nga marsi 2016 edhe ata që e kanë lëshuar Kosovën pas 28 korrikut 2010 mund të përfitojnë nga skemat riintegruese, përveç ndërtimit të shtëpive).
- Aplikacionet duhet të paraqiten në Zyrat Komunale për Kthim (ZKK) të themeluara në secilën komunë. Ndihma në fillim të biznesit mund të arrijë shumën 2000 EUR, por jo me para të gatshme.
- Qendrat e punësimit dhe UNDP ndihmojnë të kthyerit me subvencion të pagave.

2. Përkrahja për fillimin e aktiviteteve të gjenrimit të të ardhurave

Përveç kredive bankare, të cilat janë në dispozicion në çdo kohë, ofertat për projekte të kohë-pas-kohshme nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin dhe organizatat e shoqërisë civile, janë të kufizuara.

VIII. INFORMATAT E KONTAKTEVE DHE VEGËZA TË DOBISHME

<p>UNDP Adresa: UNDP Zyra në Kosovë, rr. Zagrebi, nr. 39, 10 000 Prishtinë E-mail: registry.ks@undp.org Tel: +381 (0) 38 249066 Fax: +381 (0) 38 249065 Website: www.ks.undp.org</p>	<p>UNHCR Adresa: rr. Lorenc Antoni, nr. 26, Pejton, 10 000 Prishtina E-mail: halilis@unhcr.org Tel: +381 (0) 38 241 509 Website: www.unhcr.org</p> <p>Personi kontaktues: Shpend Halili E-mail: halilis@unhcr.org</p>
<p>Departamenti i Riintegration – Ministria e Punëve të Brendshme Adresa: rr. “Luan Haradinaj” p.n. 10 000 Prishtinë Tel: +381 38 521 266 Website: www.mpb-ks.org</p> <p>Contact Person: Fahrije Ternava E-mail: Fahrije.Ternava@rks-gov.net</p>	<p>Departamenti i Punësimit Adresa: Ndërtesa e Qeverisë, Prishtinë E-mail: Ylber.A.Aliu@rks-gov.net Tel: +381 38 200 26 112 Website: https://mpms.rks-gov.net</p> <p>Contact Person: Ylber Aliu E-mail: Ylber.A.Aliu@rks-gov.net</p>
<p>Qendra Klinike Univerzitare Adresa: Rrethi i Spitalit p.n., Prishtinë Tel: +381385 00 600</p>	<p>Agjensia Kosovare e Pronës Adresa: rr. “Perandori Justinian”, nr. 5, Qyteza Pejton, 10 000 Prishtinë Tel: +381 38 249 918 Fax: + 381 38 249 919 Website: http://kpaonline.org</p>
<p>Agjensia Kosovare e Statistikave Adresa: rr. “Zenel Salihu”, nr. 4 10 000 Prishtina E-mail: economic@rks-gov.net Tel: +381 (0) 38 200 31 129 Fax: +381 (0) 38 235 033 Website: http://ask.rks-gov.net</p>	<p>APPK Adresa: rr. Andrea Gropa p.n. 10 000 Prishtina Tel: +381 (0)38 24 34 74 Fax: +381 (0)38 24 34 75 Website: http://appk.org Personi kontaktues: Bedri Xhafa</p>